



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1382/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Francika Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në konfliktin administrativ të paditësve-propozuesve “The Business Club” L.L.C, me seli në Prishtinë me NUI: 812011683, i përfaqësuar sipas autorizimit nga I.I., në cilësi të Drejtorit menaxhues, kundër të paditurës-kundër propozueses Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurës nr.5341/01-KOM i dt. 11.09.2023 dhe vendimit 522 i dt. 07.08.2023, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit-propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë,- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.386/23, të datës 19.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit “The Business Club” L.L.C, me seli në Prishtinë me NUI: 812011683, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë,- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.386/23, të datës 19.09.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit-propozuesit “The Business Club” L.L.C, me seli në Prishtinë.
- II. SHTYHET ekzekutimi i Vendimit nr.5341/01-KOM i dt. 11.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr.522 i dt. 07.08.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin

e Bizneseve në Kosovë, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit-propozuesit “The Business Club” L.L.C, me seli në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.5341/01-KOM i dt. 11.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 522 i dt. 07.08.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë.

Kundër këtij Aktvendimi, ka ushtruar ankesë paditësja-propozuesja , me të cilën e ka kundërshtuar Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vërtetimit dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditëses-propozueses dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative ta prish.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala e paditur- kundër propozuesja edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 17.10.2023, cka vërtetohet përmes fletëkthesës që gjendet në shkresat e lëndës.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi nuk ka argumentuar se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, si dhe nuk ka argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të

përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së. Pra, paditësi nuk e ka mbështetur në ndonjë provë kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të vendimit ashtu që të njëjtën nuk e ka bërë të besueshme mbi ndonjë bazë reale se ekzekutimi i vendimit paditësit do ti sillte ndonjë dëm vështirë të riparueshëm.

Në këtë kuptim gjykata në shkallë të parë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22.2 dhe 6, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Këtë vlerësim gjykata e shkallës së parë e mbështet në faktin se paditësi nuk ka ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej.

Sipas kolegjit të kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) dhe neni 194, të LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate vëren se, në rastin konkret paditësi-propozuesi me propozim ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues me nr.5341/01-KOM i dt. 11.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 522 i dt. 07.08.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e propozueses për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nr.5341/01-KOM i dt. 11.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 522 i dt. 07.08.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson se me qëllim të vlerësimit të kësaj kërkesë, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: “Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”. Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se

“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni” .

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë pasi vlerësoi kërkesën e paditësit-propozuesit, shkresat e lëndës, por edhe përmbajtjen e vendimeve kontestuese, konstatoi se Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë me Vendimin nr. 522 i dt. 07.08.2023 ka vendosur që të shfuqizoj certifikatën e biznesit të “The Business Club” L.L.C, me seli në Prishtinë me NUI: 812011683 duke e obliguar paditësin që në afat prej 5 ditësh nga dita kur vendimi bëhet i plotfuqishëm , të dorëzoj në ARBK, Certifikatën e Biznesit origjinale, me arsyetimin se duke iu referuar Raportit të Komisionit nr.4427/02 të datës 21.07.2023, rezulton që në dosjen e Shoqërisë Tregtare “THE BUSINESS CLUB” L.L.C me NUI: 812011683, është prezentuar dokumenti identifikues pasaporta me nr. E59UK3155 e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi në emër të B.D. (pronar i shoqërisë tregtare), ku në rubrikën vendi i lindjes është shkruar PEC, SRB dhe se përmbajtjet e tilla nuk lejohen në Republikën e Kosovës, për shkak se emërtimi i përdorur për vendlindjen dhe shtetin, ka shkaktuar shkelje të normave kushtetuese dhe një veprim i tillë, paraqet kërcënim serioz ndaj sigurisë publike të përcaktuar me nenin 57 dhe 58 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me datë 15.08.2023 paditësi-propozuesi ushtron ankesë ndaj vendimit të lartpërmener duke kërkuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave që ankesa e paditësit të aprovohet dhe të anulohet vendimi 522 i dt. 07.08.2023 . Me datë 13.09.2023, paditësi pranon vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, ku ky komision ka vendosur që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.522 i dt. 07.08.2023.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit-propozuesit të paraqitura në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese dhe vlerësoi se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi-propozuesi ka argumentuar faktin se ekzekutimi i vendimeve do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, si dhe ka argumentuar se shtyrja nuk

është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se ekzekutimi i vendimeve kontestuese paditësit-propozuesit do ti sillte dëme vështirë të riparueshme pasi që ekzekutimi i vendimit për shfuqizimin e certifikatës së biznesit në parim e pezullon dhe e lë pa efekt regjistrimin e paditësit si person juridik, i cili regjistrim sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i jep të drejtën për të ushtruar veprimtari ekonomike në Kosovë. Gjykata po ashtu vlerëson se për shkak të shfuqizimit, certifikata e biznesit e humb efektin juridik, e për pasoj edhe regjistrimi i paditësit-propozuesit në ARBK, andaj paditësi-propozuesi nuk mund të ushtroj as veprimtari tjetër ekonomike për shkak të certifikatës së shfuqizuar, i cili shfuqizim ka për efekt shuarjen/ndalimin e çfarëdo veprimtarie të paditësit. Si rrjedhojë, shfuqizimi i certifikatës së biznesit do të rezultonte me ndërprerjen e marrëdhënieve tjera kontraktuale me palët e treta, rrethana këto që në rast të ekzekutimit të vendimeve kontestuese paditësit-propozuesit do ti sillnin dëme vështirë të riparueshme.

Gjykata gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se sipas Certifikatës së Regjistrimit nr. ser. 10156755 dhe informatat e biznesit, paditësja-propozuesja është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila sipas ligjit është juridikisht e ndarë nga aksionarët, e regjistruar në Kosovë me datë 09.02.2023 dhe se pasaporta e njërit prej aksionarëve është e Republikës së Malit të Zi, ndërsa këtë fakt e paditura e ka përdorur si arsye për shfuqizim të certifikatës së biznesit të paditësit pa u bazuar në ndonjë akt ligjor nga ana e ARBK-së, dhe se vazhdimi i përdorimit të toponimeve të Komunave të Kosovës, me shtetin e origjinës në Serbi, në pasaportat e lëshuara nga shtete njohëse me shumë mbetet çështje administrative apo teknike e cila do të mund të ndryshohej përmes komunikimit të autoriteteve diplomatike të Republikës së Kosovës dhe këtyre shteteve që vazhdojnë që pasaportat për shtetasit e tyre me prejardhje nga Kosova i lëshojnë me shtetësinë e Serbisë.

Gjykata po ashtu vlerëson faktin se paditësi-propozuesi ushtron aktivitet ekonomik dhe përderisa vazhdimi i ushtrimit të njëjtit funksion nuk përbën shkelje të interesit publik, gjykata në këtë rast vlerëson se mos shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese do të ishte pikërisht në kundërshtim me interesin publik dhe garancioneve që përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e zbatueshme.

Lidhur me plotësimin e kushtit të tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, përkatësisht dëmit që mund ti shkaktohet palës së paditur-kundër propozese me shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, gjykata vlerëson se nuk ekziston ndonjë rrethanë sipas të cilës të paditurit-kundër propozuesit do ti shkaktohej ndonjë dëm nga shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese.

Andaj, për ta shmangur rrezikun e dëmit që mund të i shkaktohet paditësit-propozuesit në rast të ekzekutimit të vendimeve të lartcekura dhe duke pasur parasysh faktin se shtyrja e ekzekutimit të tyre nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe palës kundërshtare nuk i shkakton ndonjë dëm, gjykata vendosi ta aprovoj kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor, sipas padisë së ushtruar nga paditësi-propozuesi.

Këtë vlerësim gjykata e mbështeti në faktin se paditësi-propozuesi ka dhënë prova dhe argumente konkrete e të mjaftueshme se bazuar në dispozitat e cekura më lartë, janë përmbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore që të aprovohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara derisa gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara përkitazi me padinë e paditësi ku do të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palëve të paraqitura dhe që do të paraqiten në ardhmen.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjenë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që ankesa të aprovohet dhe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, duke aprovuar propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve kontestuese.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën c) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1382/23, datë 26.10.2023

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti, d.v